



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.4.2022, ora 11:30

#### **Drejton mbledhjen:**

**Petro Koçi – zëvendëskryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

Diskutimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Bashkimit Europian “Horizont Europa”, programi kuadër për kërkimin dhe inovacionin” (*komision përgjegjës*)

#### **Marrin pjesë:**

Petro Koçi, Besion Ajazi, Eduard Ndreca, Teuta Ramaj, Ilir Topi, Lindita Buxheli, Blerina Gjylameti, Florenc Spaho, Dasantila Tahiraj, Enslemvera Zake, Meri Markiçi, Ina Zhupa, Eralda Bano, Merita Baku, Andia Ulliri, Kastriot Piroli dhe Lavdrim Krrashi (zëvendësues).

#### **Mungojnë:**

Flutura Aça, Agron Gjekmarkaj dhe Luçiano Boçi.

#### **Të ftuar:**

Albana Tole – Zëvendësministre e Arsimit dhe Sportit,  
Mirela Muça – drejtore e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit,  
Florian Nurçe – përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar,  
Voltisa Koçi – përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator.

## HAPET MBLEDHJA

**Petro Koçi** – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Ashtu siç e kemi lënë në kalendar, sot në rendin e ditës kemi diskutimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Bashkimit Europian “Horizont Europa”, programi kuadër për kërkimin dhe inovacionin”. Ne jemi komision përgjegjës.

Të ftuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve kemi zonjën Albana Tole, zëvendësministre, mirë se erdhët zonja zëvendësministre, zonjën Mirela Muça, drejtore e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, zotin Florian Nurçe, përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, dhe zonjën Voltisa Koçi, përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në këtë Ministri.

Ashtu siç është rregulli i komisionit, një prezantim nga ana e ministrisë ose qeverisë për projektligjin, më pas e merr fjalën relatori.

Zonja Zëvendësministre, fjala për ju.

**Albana Tole** – Faleminderit, zoti zëvendëskryetar!

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Bashkimit Europian “Horizont Europa”, programi kuadër për kërkimin dhe inovacionin” ka si qëllim përcaktimin e kriterëve dhe kushteve që duhet të përmbushë Republika e Shqipërisë për të qenë pjesë e programit në fjalë, pra e programit “Horizont Europa”, programi kuadër për kërkimin dhe inovacionin.

Çdo 7 vjet Komisioni Europian shpall programin kuadër për kërkimin shkencor dhe inovacionin. “Horizont Europa” është një instrument financiar i hapësirës europiane të kërkimit që synon të nxisë kërkimin shkencor dhe inovacionin nëpërmjet rritjes së numrit të pjesëmarrësve në projektet kërkimore, në mënyrë që të financojë kërkimin shkencor, inovacionin dhe të ketë një impakt zhvillimi ekonomik dhe social, duke gjeneruar edhe vende pune.

BE-ja synon të krijojë një treg të vetëm për kërkimin shkencor dhe inovacionin, duke nxitur dhe duke lehtësuar bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të arsimit të lartë, duke shkëmbyer praktikat më të mira dhe duke zhvilluar një karrierë kërkimore në mbarë Europën.

Ky projektakt është në përputhje me strategjinë kombëtare për zhvillimin dhe integrimin 2015-2020 dhe me strategjinë kombëtare të arsimit 2021-2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj. Nëpërmjet këtij programi Republika e Shqipërisë, pra Ministria e Arsimit dhe Sportit, i paguan Bashkimit European një kuotë anëtarësimi vjetore nëpërmjet së cilës bëhet e mundur që institucionet e arsimit të lartë shqiptarë të kryejnë kërkim shkencor dhe të marrin pjesë në projektet e ndryshme kërkimore në bashkëpunim me institucione të tjera partnere.

Një nga problematikat e kësaj marrëveshjeje është kontributi financiar që duhet të paguajë Republika e Shqipërisë, në raport me fondet që mund të përthithen nëpërmjet aplikimit për projekte, duke pasur parasysh konkurrueshmërinë e institucioneve të arsimit të lartë në rajon, pra në Bashkimin European dhe më gjerë. Falë zbatimit të kësaj marrëveshjeje, synohet që institucionet e arsimit të lartë shqiptar të zhvillojnë dhe të ngrenë ndjeshëm nivelin e tyre të kërkimit shkencor, duke përthithur një numër më të madh fondesh në krahasim me programet, të cilat janë zhvilluar më parë.

Pjesëmarrja në këtë program është kusht për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin European, paraqitur në kapitullin 25 “Shkenca dhe kapitulli shkencor”. Duhet theksuar se Shqipëria ka qenë pjesë e programit të mëparshëm kuadër për kërkim shkencor dhe inovacionin, konkretisht për vitet 2007-2013 në programin PF7 “*7th Framework Programme of the European Community*” dhe për vitin 2014-2020 nëpërmjet programit “Horizont 2020”. Gjatë kësaj periudhe pjesëmarrja e Shqipërisë ka qenë gjithnjë e më shumë në rritje. Pra, në programin PF7 2007-2013 numri total i aplikimeve ka qenë 245, ku projektet e fituara janë 27 dhe financimi i përfituar është 2 milionë euro. Ndërkohë që në programin “Horizont 2020” kanë qenë 605 aplikime, numri i projekteve të fituara 52 dhe financimi i përfituar 5 milionë e 519 mijë e 546 euro. Ky rezultat ka ardhur duke u dyfishuar ose më mirë, më shumë se sa i dyfishuar, ka pasur një rritje prej 275%. Rezultatet e Shqipërisë kanë ardhur gjithnjë e më rritje. Kjo na bën të mendojmë që edhe për programin e ri “Horizont Europë” performanca e Shqipërisë do të vijë në rritje, duke marrë në konsideratë që edhe institucionet e arsimit të lartë, në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimi, kanë rritur numrin e tyre të bashkëpunimit me institucionet e arsimit në Bashkimin European dhe në rajon.

Në të njëjtën kohë vlen të theksohet fakti se në vitin 2021 kemi informacion se dy subjekte nga Shqipëria kanë fituar projekte në cilësinë e liderit dhe kjo gjë verifikohet për herë të parë, pasi nga përvoja e viteve të mëparshme në shumicën e rasteve aplikantët shqiptarë në projektpropozimet e paraqitura kanë qenë në rolin e partnerit, pjesë e konsorciumeve më të gjera, të cilat janë koordinuar nga anëtarë të vendeve të Bashkimit Europian dhe vendeve të asociuara. Ky është motivi për të cilin jemi të bindur se edhe programi i ri, pra programi “Horizont Europë 2021-2027” do ta rrisë akoma më shumë performancën, duke justifikuar kontributin që qeveria shqiptare paguan për pjesëmarrjen në këtë program. Ndërkohë, Ministria e Arsimit është duke punuar për ngritjen e kapaciteteve, në mënyrë që të kemi disa ekspertë, të cilët merren me shkrimin e projekteve dhe që mund të garantojnë një nivel përgatitor më të madh, detyrimisht edhe një nivel më të lartë në pjesëmarrjen në programin në fjalë.

Faleminderit!

**Petro Koçi** – Faleminderit, zonja Zëvendësministre!

Fjalën e ka relatori Ajazi.

**Besion Ajazi** – Faleminderit, zoti zëvendëskryetar!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar përfaqësues të ministrisë,

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin e Bashkimit Europian “Horizont Europa” është një projektligj në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me ligjin nr. 9590/2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komitetit Europian dhe të shteteve të tyre anëtare.”.

Gjithashtu, ky projektligj është në përputhje me ligjin nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe respekton kërkesat e Rregullores së Kuvendit për paraqitjen e tij në Kuvend.

Si komision përgjegjës, dua të zgjatem pak në relatimin e këtij projektligji për të qenë edhe më shterues, pavarësisht të gjithë informacionit të detajuar që zonja zëvendësministre dha për komisionin, por për procedurë dhe për të vënë në dijeni njerëzit që na ndjekin, duhet të zgjatem pak.

Ky projektligj është i mbështetur në nenet 78-83 dhe nenin 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Falë zbatimit të kësaj marrëveshjeje, synohet që institucionet e arsimit të lartë shqiptar të zhvillojnë dhe të ngrenë ndjeshëm nivelet e tyre të kërkimit shkencor, duke përthithur fonde nga ky program edhe në bashkëpunim me institucionet arsimit të lartë europian. Performanca e Shqipërisë në programin e “Horizont 2020” nga viti 2014 deri në vitin 2020 ka përmbushur objektivat e strategjisë kombëtare për kërkimin shkencor 2017-2022; janë rritur aplikimet dhe projektet e fituara me më shumë se 10% në vit. Pjesëmarrja në këtë program është kusht edhe për integrimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian, paraqitur në kapitullin 25 “Shkenca dhe kërkimi shkencor”. “Horizont Europa” është faza e 9 programeve kuadër në kërkim shkencor dhe zhvillim teknologjik, që financohet nga Bashkimi Europian për të mbështetur dhe për nxitur kërkimin shkencor në hapësirën europiane të kërkimit. Ky program komunitar mbështetet në strategjinë e Bashkimit Europian për inovacionin dhe do të zbatohet për periudhën 2021-2027 “Horizont Europa”, që është një instrument financiar për nxitjen e kërkimit shkencor dhe inovacionit, i cili ka si qëllim sigurimin e konkurrencës globale të Europës, duke nxitur më tej rritjen ekonomike dhe duke krijuar, pse jo, edhe vende pune.

Gjithashtu, ky projektligj sjell efekte financiare shtesë në buxhetin shtetit, që përcaktohen në nenin 3 të marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Bashkimit Europian dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Sigurisht, efektet financiare janë shtrirë gjatë këtyre 7 vjetëve dhe janë ndarë vit për vit në masën e caktuar nga viti 2021, që është 1 milion e 298 mijë euro deri në vitin e fundit 2027, që është 1 milion e 400 mijë euro.

Së fundi, për të mos u zgjatur edhe në detajet të tjera specifike dhe teknike, që kanë të bëjnë me këtë marrëveshje, unë do ta vlerësoja këtë si një gjë shumë të mirë për institucionet e arsimit të lartë, duke u dhënë atyre një mundësi më shumë për të dalë, për të konkurruar dhe për të thithur fonde në Europë për t’i bërë institucionet e arsimit të lartë edhe më konkurruese, por edhe më produktive.

Dua t’i ftoj të gjithë kolegët e komisionit që ta miratojnë këtë marrëveshje.

Faleminderit!

**Petro Koçi** – Faleminderit, zoti Ajazi!

Përpara se t’ua jap fjalën kolegëve për pyetje, dua të them se ky është një program shumë i rëndësishëm, që buxheton kërkimin shkencor dhe inovacionin në vendet anëtare, por edhe në vende që janë në pritje të hapjes së negociatave për anëtarësim. Është një program që vjen për herë

të tretë në parlament. Sigurisht, duket qartazi që ka ardhur në rritje përfitimi i Shqipërisë nga pjesëmarrja në këtë program, por siç dihet ky është një program edhe kësaj radhe 7-vjeçar, është një buxhetim i jashtëzakonshëm që bën Bashkimi European. Është 95 miliardë euro, më duket, dhe varet shumë nga aftësia jonë për të përthithur fonde që të shfrytëzohet jo thjesht nga pikëpamja financiare, por për të nxitur kërkimin shkencor dhe inovacionin, i cili më pas sjell edhe hapësira më të mëdha ekonomike, duke përfshirë edhe hapjen e vendeve të reja të punës. Kjo është një mundësi e madhe për rininë, jo vetëm për segmente tashme të konfirmuara shkencore, por edhe për studentët e rinj apo të sapodiplomuar që të bëhen pjesë e përfitimit nga ky projekt i jashtëzakonshëm. Besoj se ajo që del si detyrë është fakti që Shqipëria duhet t'i trajtojë më mirë të gjitha ata organizma shkencorë universitarë apo edhe të tjerë publikë ose jopublikë që të përfitojnë fonde, sepse, duke parë disa programe të tjera, duket se ne jemi më pas. Domethënë, ne kemi më shumë nevojë për t'i trajnuar të gjithë ata që kanë mundësi për të aplikuar, në mënyrë që t'i plotësojnë kriteret e rrepta që kanë zakonisht këto lloje programesh. Domethënë, nuk është mirë që Shqipëria, në krahasim me vendet e rajonit, të vazhdojë të jetë më pas.

Sigurisht, kjo nuk është një çështje e mirëfilltë politike, por edhe politika dhe qeveria ka përgjegjësinë e saj, sidomos në programet e trajnimit, sepse kjo varet edhe nga kapacitetet që kanë universitetet tona, duke përfshirë ato publike dhe ato jopublike apo edhe struktura të tjera shkencore, siç janë akademitë apo dhe ndërmarrjet, si sipërmarrje shkencore private.

Kështu që dua të hap pjesën e pyetjeve. Kush ka pyetje brenda kuadrit të marrëveshjes, që të sqarohemi më mirë, në lidhje me përmasat dhe shanset që na jep ky projektligj, duke e bërë Shqipërinë edhe një herë pjesëmarrëse në një projekt, siç është “Horizont Europa”.

Kush e dëshiron fjalën?

Zonja Gjylameti, fjala për ju.

**Blerina Gjylameti** – Faleminderit, zoti zëvendëskryetar!

Duke e vlerësuar maksimalisht këtë marrëveshje, që i jep mundësi të gjithë pjesës së trupës akademike shqiptare për të aplikuar për projekte, të cilat do të mbështesin pjesën e kërkimit shkencor, të cilin e kemi pasur në prioritet tona vazhdimisht, duke e lidhur këtë me eksperiencën time në pjesën e arsimit dua të them se është një mundësi shumë e mirë për të gjithë pedagogët shqiptarë, por jo vetëm, për të arritur të kenë fonde për të vijuar pjesën e kërkimit. Nga ana tjetër, duhet të jemi shumë të kujdesshëm në atë që ju thatë pak më parë, në pjesën e trajnimit dhe fuqizimit të kapaciteteve tona për të thithur fonde të huaja, sepse e kemi vënë re rregullisht që

cedojmë në pjesën e hartimit të projekteve, ashtu siç duhet, për t'i përthithur këto фонде. Nga ana tjetër, duhet të kemi fokusin e veçantë për mirëmenaxhimin e фондеве publike dhe të pagesave që bëjnë ministrinë përkatëse për t'i përthithur këto фонде.

Kam një pyetje në lidhje me faktin që ne japim një kontribut diku te 8,1 milionë, ndërkohë përfitojmë 5,5 milionë. E tha pak më parë zoti Koçi, dhe unë besoj se duhet të fokusohemi pak më shumë bashkë me drejtoreshën e Arsimit të Lartë, por edhe me një numër të caktuar pedagogësh me grada të larta shkencore, që e kanë ngritur këtë shqetësim, në përthithjen e фондеве. Nga ana tjetër, besoj se kemi detyrimin në këtë rast për të ngritur një institucion ose për të fuqizuar këtë institucion që kemi, duke marrë parasysh autonominë që u jep universiteteve ligji “Për arsimin e lartë” për të bërë pikërisht trajnimin. Në këtë aspekt, dua të di nga ana juaj se çfarë po bëhet. I kemi diskutuar këtu në këtë komision edhe me ministrinë e tjera përkatëse mangësitë që kemi në përthithjen e фондеве të huaja, por, nga ana tjetër, edhe në shfrytëzimin e kësaj mundësie. Sado që të jetë buxheti i shtetit dhe sado që ne ta rrisim pjesën e përqindjes së buxhetit të shtetit, që i dedikohet arsimit të lartë, kurrsesi nuk mund të krahasohemi me fondet që janë nga Bashkimi European, të cilat mund t'i shfrytëzojmë për të rritur cilësinë jo vetëm të trupës akademike, rrjedhimisht të mësimdhënies dhe të atyre që dalin në tregun e punës.

U zgjata pak, por pyetjen e kam shumë konkrete, sepse e kemi bërë këtë pyetje edhe me ministrinë e tjera: duhet një institucion, një drejtori që ngrihet nga ministria apo fuqizohet nga ministria për të trajnuar të gjithë trupën, në mënyrë të tillë që të përthithin фонде. Nga ana tjetër, atë që kemi thënë gjithmonë, ne kemi studime, të cilat bëhen nga trupa akademike që shpeshherë nuk gjejnë zbatim. Në kuadër të marrëveshjeve që janë bërë ndërmjet ministrive përkatëse dhe universiteteve, në kuadër edhe të asaj që kemi diskutuar dikur, për pjesën e gjetjes, bashkimit apo koordinimit ndërmjet asaj çfarë kërkon tregu dhe çfarë ofrojnë universitet, çfarë është duke u bërë konkretisht? E kam fjalën për të gjitha ato kërkime shkencore që i vlejnë tregut, por, mbi të gjitha, që u vlejnë edhe institucioneve publike. A kemi ne marrëveshjet tilla? Ku jemi dhe çfarë po bëni që në fund edhe fondet, që përthithen, t'i shërbejnë tregut shqiptar.

Faleminderit!

**Petro Koçi** – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Kësaj pyetje dua t'i bashkohem edhe unë, në njëfarë mënyre pjesëmarrja në një program është e detyruar, sepse, me sa duket, Bashkimi European i detyron vendet anëtare dhe ata që pretendojnë për t'u anëtarësuar, të jenë pjesë dhe të investojnë detyrimisht për kërkimin shkencor

dhe inovacionin, por, përtej kësaj, përfitimi nuk ka garanci, po themi automatike, sepse varet shumë nga ajo që e theksuam deri tani nga niveli dhe kapaciteti i aplikimeve. A është e mundur që ministria me të gjitha institucionet me natyrë shkencore, universitare ose jo, publike ose jo të organizojë takime me natyrë trajnuese, sidomos për t'i orientuar drejt projekteve që kanë leverdi nga pikëpamja ekonomike, nga pikëpamja e hapjes së vendeve të punës dhe nga pikëpamja e nxitjes së shpirtit shkencor te brezi i ri? Unë i bashkohem kësaj pyetje që bëri kolegja Gjylameti.

Faleminderit!

Fjala për ju, zonja Zëvendësministre.

**Albana Tole** – Faleminderit për pyetjen!

Ashtu siç e citova pak më parë, gjatë prezantimit duhet marrë në konsideratë se cilat kanë qenë rezultatet që kemi arritur në pjesëmarrjen në programin e parë PF7 2007-2013 dhe në programin e dytë, sepse ajo është përvoja që ne kemi në mënyrë të drejtpërdrejtë, pra programi “Horizont 2020” 2014-2020. Pra, nëse marrim në konsideratë të dhënat që kemi nga pjesëmarrja në këto dy programe, do të vihet re që financimi i përfituar nga ana e institucioneve shqiptare në programin e parë ka qenë 2 milionë euro, ndërsa në programin e dytë 5,5 milionë euro. Domethënë, sasia e fondeve që institucionet tona kanë arritur të përthithin është më shumë se dyfishuar. Sigurisht, nëse do të duhet që këto të dhëna t'i krahasojmë me shtetet e ndryshme në rajon, janë të dhëna ose më mirë sasi më të vogla, pra ne kemi një përqindje suksesi që është më e vogël se në vendet e tjera në rajon, por, në të njëjtën kohë, duhet vënë fokusi mbi faktin që cilësia ka ardhur duke u përmirësuar dhe përvoja e institucioneve në këta 14 vjet ka ardhur duke u rritur. Kjo ka ndodhur si efekt i pjesëmarrjes së vazhdueshme në këto programe, por, në të njëjtën kohë, edhe si efekt i bashkëpunimeve që këto institucione kanë me institucione të tjera në rajon. Pra, rritja e numrit të bashkëpunimeve të institucioneve të arsimit të lartë vendase me vende të ndryshme në rajon ka bërë që ne të jemi partnerë në projekte të ndryshme që janë paraqitur gjatë këtyre 14 vjetëve dhe kjo të rrisë nivelin e suksesit. Këto kanë qenë konsorciume, pra ne kemi qenë pjesë e këtyre konsorciumeve dhe kështu janë përfituar pjesa më e madhe e fondeve, por, ashtu sikurse e përmenda pak më parë, kemi një të dhënë pozitive në lidhje me vitin 2021, ku specifikohet që për herë të parë ne, si vend, kemi marrë pjesë dhe kemi fituar si lider. Pra, nuk jemi pjesë e një konsorciumi, por jemi vetë lider. Kjo, në vetvete, tregon një përmirësim të standardit cilësor dhe, në të njëjtën kohë, një përvojë më të pjekur dhe të maturuar në marrjen pjesë në këto projekte.



Ministria e Arsimit, në të njëjtën kohë është duke punuar në mënyrë që të ngrëjë kapacitetet e institucioneve të arsimit të lartë në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë në BE për të ngritur module trajnimi, ku do të marrin pjesë stafe të dedikuara fushës së kërkimit shkencor dhe në të njëjtën kohë pse jo dhe programe studimi, master profesional, të cilët ndihmojnë në ngritjen e kapaciteteve dhe nënshkrimin e projekteve, në mënyrë që pjesëmarrja jonë të rezultojë më e suksesshme në këtë program të ri, që është Horizont Europa. Vlen të theksohet edhe fakti që, duke e marrë në konsideratë rritjen që ka pasur ndërmjet programit të parë dhe të dytë përqindja e suksesit ka qenë shumë më e lartë, nga 2 milionë në 5,5 milionë do të thotë 275% më shumë, i cili është një indikator pozitiv.

**Petro Koçi**- Faleminderit!

**Mirela Muça** – Kurba e nivelit të suksesit në pjesëmarrjen e Shqipërisë në Horizont ka ardhur duke u rritur. Ne themi që është 8% gjatë programit kuadër të Horizont 2020, por që 8% është një mesatare, nuk ka filluar me 8%, por ka filluar me 1,6% në vitin 2014 dhe jemi me 14% në 2020. Ko është për të treguar trendin e suksesit që kanë pasur institucionet shqiptare në aplikimin në Horizont.

Lidhur me pyetjen e dytë që bëri zonja deputete, si po punojmë ne për të incentivuar bashkëpunimin e komunitetit të kërkuesve shkencor dhe qarqeve akademike që merren me kërkim shkencor me institucionet tona, në mënyrë që kërkimi shkencor të vlejë jo vetëm si kërkim për kërkim dhe të mbyllet brenda auditorëve dhe laboratorëve të universiteteve, por t'i shërbejë zgjidhjes së problematikave që kanë institucionet tona, ose që ka biznesi shqiptar. Për këtë, në programin kombëtar të mbështetjes së kërkimit dhe zhvillimit, pra të mbështetjes të aktivitetit të kërkimit shkencor brenda universiteteve, ne kemi vënë një kusht incentivues që ato institucione, të cilat do të marrin pjesë si projektpropozues për kërkim shkencor do të incetivohen dhe do të kushtëzohen bashkëpunimin me institucionet dhe me biznesin. Nuk kemi arritur një sukses 100%, domethënë, që ët gjithë ata që kanë aplikuar për fonde, për mbështetje të kërkimit shkencor ka një marrëveshje bashkëpunimi, por, gjithsesi, e kemi filluar këtë gjë në dy programet e fundit të vitit 2021 dhe 2022 dhe kemi rritje të aplikimeve të përbashkëta të universiteteve me biznesin, ose të universiteteve me institucionet publike, sidomos me bashkitë.

**Petro Koçi**- Unë sugjeroj që do të ishte e udhës që të gjitha këto struktura që kanë kapacitet shkencor, kërkimor ose inovativ, të marrin informacion nga shumëllojshmëria e të gjitha institucioneve qeveritare ose jo, ku të marrin vesh se çfarë problematikash ka dhe që nuk ecin në

këtë vend. Kjo do të thotë që, nëse ata nëpërmjet kërkimit shkencor i japin përgjigje, atëherë, kërkimi do të jetë i leverdishëm. Ka organizata joqeveritare, që janë me natyrë kritike, nuk po them opozitare politikisht, që në qoftë se merr një informacion nga ato, atëherë mund të zbulohen natyra kërkimi që do të vlejë më shumë sesa ato të vetëshpikura, që për qëllim mund të kenë vetëm financimin, pra, vetëm një lloj marrjeje buxhetimi; ne duam kërkim shkencor që jep fryt. Kjo është ideja.

Faleminderit!

Zonja Zhupa, fjala për ju.

**Ina Zhupa-** Faleminderit!

Nëse mundem, a mund të them diçka për procedurë?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Jo, është një kërkesë e arsyeshme dhe brenda rregullave. Unë dhe zonja Dasantila jemi relatores në një projektligj që lidhet me Parkun Kombëtar të Butrintit dhe bëhet fjalë për një takim që do të zhvillohet ditën e martë në orën 11:30. Unë kam kërkuar pranë sekretarisë, besoj edhe zonja Dasantila, është në dijeni që nuk është sjellë marrëveshja. Nëse ne nuk na sillen marrëveshja të paktën deri ditën e premte këshilloj që ta spostoj me çështje të tjera të kalendarit. Të na sillen marrëveshja këtu së bashku me të gjitha aktet që ne na duhen, në mënyrë që ne edhe ta diskutojmë. Kjo ishte për procedurë brenda rregullave të parlamentit dhe jo në mënyrë se si mund të aksesojmë. Ne mund ta marrim me miq dhe me shokë, por ideja është që duhet të vijë institucionalisht nga sekretaria e t'i përcillet të gjithëve. Kjo ishte për procedurë.

Për sa i përket çështjes që ne kemi. Sigurisht që Partia Demokratike, opozita, është pro ratifikimit të kësaj marrëveshjeje dhe besoj se nuk ka ndonjë dyshim për këtë pjesë, sepse janë detyrime që ne na lindin si vend, i cili aspiron për Bashkimit Europian, por edhe përfitime që duhet të kishim në një masë më të madhe, që, në fakt, i bashkohem edhe asaj që tha edhe Blerina, që përfitimet që ne kemi marrë në krahasim me atë që kemi paguar janë në një raport që nuk e justifikojnë veten, ndërkohë që shtetet e tjera marrin shumë më shumë përfitime sesa është pagesa që japin. Për mendimin tim, problematika këtu fillimisht është, sepse ne, si Shqipëri, kur them ne kam parasysh problematikat qeveritare me Ministrinë e Arsimit, kemi nivelin më të ulët të financimit për kërkimin shkencor se vendet e tjera të rajonit apo të BE-së. Normalisht ka një raport të drejtë që ti kur financon pak për kërkimin shkencor, edhe kapacitetet e tua janë më të ulëta dhe do të marrësh më pak. Kështu që, ky është një raport i drejtë midis asaj që financojmë dhe asaj që

marrim; vendet e tjera financojnë më shumë dhe marrin edhe më shumë se ne. Ky është një shpjegim i thjeshtë për të kuptuar që, nëse duam ta ndryshojmë këtë raport, duhet ta fillojmë pikërisht me rritjen e përqindjes që japim nga buxheti për kërkimin shkencor, në mënyrë që të rrisim edhe kapacitetet.

Në lidhje me këtë marrëveshje, dua t'ju drejtoj disa pyetje dhe pastaj, nëse kam të tjera, i rezervoj vetes të drejtën për komente.

Së pari, është folur dhe ka qenë edhe pjesë e asaj që Kryeministri ka premtuar dhe ka thënë për krijimin e asaj platforme që ishte *Albania Exelente*. Një platformë, e cila do të na ndihmonte që të merrnim edhe ekspertizën e profesionistëve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit. Sa funksionale ka qenë kjo platformë? A kemi pasur mundësi ne që të marrim ekspertizën e profesionistëve shqiptarë, që jetojnë jashtë vendit për të aplikuar për projekte në drejtim të kësaj marrëveshjeje që kemi, por edhe në projekte të tjera? Nëse nuk është vënë ende në funksion, kur pritet që të futet ky element të ri, meqenëse është premtim i bërë nga Kryeministri dhe e shikoj të cituar në raportet tuaja?

Pyetja e dytë ka të bëjë me ekspertët që po përgatit Ministria e Arsimit. Këta ekspertë që po përgatit Ministria e Arsimit do t'u atashohen universiteteve, apo do të punojnë në mënyrë individuale, apo pranë Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor? A është vetë Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit që ka marrë përsipër përgatitjen e këtyre ekspertëve apo do të keni trajnime, apo organizime të tjera, qoftë të huaja, qoftë kombëtare, që të kuptojmë se si funksionon kjo gjë?

Së treti, ju përmendet që nga këto bashkëpunime, nga këto projektet, janë marrë përfitime nga shteti shqiptar dhe janë krijuar edhe vende pune. Ju, si ministri, që monitoroni edhe ecurinë e këtyre projekteve, duke qenë se ne paguajmë diçka dhe nuk është pa *fee* nga shteti ynë, sa vende pune mendoni ju, apo i keni të studiuara, që janë krijuar nga këto projekte që janë marrë deri tani në këtë kuadër, meqenëse e keni cituar që krijohen edhe vende pune?

Pyetja tjetër. Kush i ka fituar projektet deri tani, institucionet publike apo ato private? Në rolin e liderit, si është raporti midis universiteteve publike dhe atyre private në drejtim të këtij projekti, jo në përgjithësi, por në drejtim të "Horizont Europa" në fitimin e projekteve?

Pyetja tjetër. Në dijeninë tuaj dhe në rezonancën që i keni bërë këtyre projekteve, si është niveli i përfshirjes së studentëve në këto projekte dhe çfarë parashikoni ju, si ministri, si politika

që mund t'i nxisni që studentët të përfshihen më shumë në ekspertizë, në pjesëmarrje brenda këtyre projekteve që aplikohen në universitetet shqiptare, qofshin publike apo private?

Zëvendësministrja përmendi që është dyfishuar sasia e parave që marrin nga vitet 2007-2013 me 2014-2020. Sigurisht janë dy kohë të ndryshme, ekspertiza e universiteteve shqiptare ka ndryshuar, cilësia e pedagogëve ka ndryshuar, pedagogë, të cilët më parë ishin me titullin “Doktor”, tani, për shkak edhe të viteve të eksperiencës kanë kaluar në “Prof.dr”, pra, gjithçka ka ecur me evoluim. Si e shikoni ju rolin e Ministrisë së Arsimit në këtë drejtim., apo është sukses i institucioneve të vetë atyre? Nëse e shikoni që dyfishimi është roli i Ministrisë së Arsimit, atëherë, të jemi të barabartë dhe të themi që është edhe roli i drejtpërdrejtë i Ministrisë së Arsimit edhe për dështimin që ne nuk arrijmë të marrim fondet që të justifikojnë pagesën që kemi. Pra, ose e quajmë me rol Ministrinë e Arsimit gjithë kohën, edhe në suksese edhe në dështime, ose themi që janë institucionet dhe ministria ka thjesht një rol ndihmës. Pra, duhet ta ndajmë mendjen dhe të themi që te sukseset është roli i ministrisë dhe te dështimet është roli i institucioneve. Këto ishin seti im i parë i pyetjeve për ju.

**Dasantila Tahiraj-** Pyetjet e mia, në fakt, janë shumë shkurt. Sigurisht që Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Informacionit është një agjenci, ku ne e pamë vetë tek takimi që patëm me një grup zonjash, të cilat kishin përfituar nga fondet e kësaj agjencie, kanë mbështetur njerëzit që janë të fokusuar te kërkimi shkencor.

Pyetja ime e parë. Zakonisht fonde kanë përfituar stafet akademike dhe trupat akademike, a ka reklamim për këto fonde, në mënyrë që të mund të përfitojnë edhe persona të tjerë që nuk janë pedagogë?

Pyetja ime e dytë. A ka ndonjë mekanizëm të zgjedhur nga ju, apo ndonjë mënyrë për të inkurajuar kërkimin shkencor për përmirësimin e cilësisë së ajrit në qytete, të cilat kanë industri të zhvilluar, apo në fabrika dhe institucione ku punojnë shumë punonjës? Sigurisht, kërkimi shkencor duhet të jetë edhe në shërbim të komunitetit, në shërbim të qytetarëve. Këto ishin pyetjet e mia.

Faleminderit!

**Petro Koçi-** Faleminderit!

Mund të filloni me përgjigjet.

**Albana Tole-** Në lidhje me rritjen e financimit për kërkimin shkencor. Duhet të thënë që fondet e nevojshme për kërkimin shkencor nuk janë asnjëherë të mjaftueshme, kjo pavarësisht vendit se ku ndodhemi. Sigurisht që çdo zhvillim ekonomik, çdo zhvillim secila kërkon një numër

fondesh që të jenë gjithnjë e më shumë në rritje, në mënyrë që të impaktojnë edhe në rritjen ekonomike të vendit, por duhet thënë që buxheti i shtetit ka ardhur duke u rritur për sa i përket kërkimit shkencor dhe inovacionit. Kjo gjë reflektohet edhe në numrin e projekteve të financuara nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.

Për sa i përket fondeve, të cilat janë përthithur nëpërmjet pjesëmarrjes në projektet e mëparshme, si për shembull, FP7, ose Horizont 2020, duhet thënë që kjo pjesëmarrje ka ardhur gjithnjë e më shumë në rritje dhe numri i fondeve të përthithura ka ardhur gjithnjë e më shumë në rritje sa i përket sensibilizimit që institucionet kanë pasur nga ana e ministrisë dhe Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit për të marrë pjesë në projekte të këtij lloji tipi, sa i përket përvojës së institucionet e arsimit të lartë kanë përfituar me pjesëmarrjen e tyre të vazhdueshme, ashtu edhe sa i përket rritjes së bashkëpunimit që institucionet e arsimit të lartë kanë pasur me institucionet partnere, ku janë bërë pjesë e konsolciumeve. Kështu që motivi për të cilin fondet kanë ardhur gjithnjë e më shumë duke u rritur kanë qenë pjesërisht motive të lidhura me politika sensibilizuese që janë bërë nga Ministria e Arsimit, por, në të njëjtën kohë, edhe me dëshirën për të rritur numrin e pjesëmarrjes dhe me rritjen e bashkëpunimeve që institucionet e arsimit të lartë kanë pasur. Kështu që mund të themi që motivi është një ndërthurje e më shumë elementeve dhe nuk është një çështje meritokracie e marrë vetëm nga Ministria e Arsimit apo institucioneve të arsimit të lartë. Sigurisht që duke marrë pjesë dhe duke pasur edhe National Contact Point, të cilët marrin informacione nga ana e BE-së dhe ia përcjellin institucioneve ose grupeve të ndryshme të interesit për të marrë pjesë në projekte të ndryshme, kjo ka sjellë një rritje të nivelit të njohurive nga ana e institucioneve, detyrimisht kanë qenë edhe më të gatshëm për të marrë pjesë nëpër projekte kërkimore. Sigurisht që pjesa më e madhe e përvojës që është krijuar deri tani ka qenë si anëtarë e pjesës së konsolciumeve ekzistuese, por me krijimin e përvojës jemi duke pasur edhe rezultatet e para nga vitit 2021, të cilat evidentojnë faktin që ne kemi fituar projekte si lider. Edhe kjo është një risi, që duhet evidentuar dhe sjellë në vëmendje faktin që ka ardhur gjithnjë e më shumë duke u rritur standardi i cilësisë. Sigurisht që rol kanë edhe institucionet e arsimit, rol ka pasur edhe eksperiencia dhe përvoja e një pjese të stafit akademik, i cili ka qenë i angazhuar më përpara në kërkim shkencor dhe në vende të ndryshme të BE-së, të cilët janë kthyer në Shqipëri dhe janë duke ushtruar profesionin e tyre si persona të punësuar në institucione të arsimit të lartë. Normalisht, kjo është pjesë e përthithjes së kapaciteteve, që personat që janë arsimuar jashtë tani i kanë sjellë në funksion të kërkimit shkencor dhe inovacionit në Shqipëri.

Këto vlejnjë të theksohen. Kështu që për t'u dhënë një përgjigje kolegëve, mund të themi që merita është e bashkëndarë, pra ndahet ndërmjet politikave që ka bërë Ministria e Arsimit dhe jo vetëm, por kanë edhe pjesën e tyre edhe institucionet e arsimit të lartë.

Ndërhyrje pa mikrofon

Nuk thashë që dështimi është i bashkëndarë dhe nuk fola për dështim, por fola për arritjet që kemi pasur deri tani. Fakti që deri në momentin aktual ne kemi pasur një përthithje të fondeve në masën 5,5 milionë euro, ndërkohë që pjesëmarrja ka qenë 8 milionë euro, deri diku është kompensuar edhe nëpërmjet rimbursimit që ne kemi marrë nëpërmjet projektit IPA dhe, detyrimisht, duke iu referuar të dhënave që kemi, nga programi Horizont 2020 2014-2020 kontributi i paguar ka qenë 8 milionë e 69 901 euro; rimbursimi i kontributit 4 milionë e 983,142 euro dhe financimi i përfituar 5 milionë 519546 euro.

Në rast se do të shohim se cilat janë fondet që kemi përthithur dhe fondet e rimuburimit, do të kuptojmë që financimi i bërë dhe i paguar nga qeveria shqiptare ka qenë i justifikuar. Kjo jo për efekt të rezultateve të arritura nga ana e përthithjes së fondeve të marra nëpërmjet projekteve kërkimore, ku ne kemi aplikuar, por edhe falë rimbursimit që kemi marrë nga komisioni. Sigurisht që ky është një instrument ndihmës, por është një instrument, i cili aplikohet dhe na ka lejuar që në këto 14 vjet ne të krijojmë përvojën për ta vënë në dispozicion të programit të ri, pra, për 7-vjecarin e ardhshëm 2021-2027. Këto janë motive, për të cilat mendojmë se rezultatet do të jenë edhe më shumë të suksesshme në krahasim me ato që kanë qenë më përpara, jo vetëm për efekt të krijimit të përvojës, por edhe si konsekuencë e faktit që ne jemi duke punuar me institucione arsimore, pjesë të vende të Bashkimi Europian, në mënyrë që të ngremë module trajnimesh për stafet brenda institucioneve të arsimit, si dhe që të rrisim kapacitetet e tyre për pjesëmarrje nëpër projekte dhe në shkrimin projekteve konkretisht.

Faleminderit!

**Petro Koçi** - Kush do të flasë nga ju?

**Mirela Muça** - Dua të vazhdoj me pyetjet.

**Petro Koçi** - Po, zonja Muça.

**Mirela Muça** - Kur flasim për kërkim shkencor, nuk mund të themi fjalën "dështim", sepse këtu nuk bëhet fjalë për një dështim të kërkimit shkencor. Flasim për një performancë të ulët të institucioneve kërkimore shqiptare. Në fakt, deri në programin e kaluar Horizont 2020, Bashkimi Europian ka qenë shumë refraktar për sa i përket kushteve të aplikimit në këtë programet. Kjo do

të thotë që ekipet kërkimore shqiptare janë ulur në rresht me ekipet kërkimore gjermane, angleze, suedeze e të tjera, pra, do të thotë që kanë qenë në të njëjtin start.

Sigurisht, ne e dimë që niveli kërkimor shkencor në Shqipëri nuk mund të krahasohet me ato të vendeve të tjera europiane, për vetë faktin se ato kanë një periudhë shumë më të gjatë që aplikojnë dhe që marrin pjesë në programe të tilla. Jetëgjatësia e institucioneve shqiptare në këto programe është relativisht e shkurtër, Ne kemi marrë pjesë vetëm në 2 programe, kur jemi në programin e nëntë, plus që aftësia për të shkruar një projekt të Horizontit është një aftësi që përfitohet me përvojë. Këtë aftësi mund ta marrësh nëpërmjet trajnimit dhe nëpërmjet shkollës, por është kryesisht një aftësi që fitohet me përvojë, sepse edhe kushtet e shkrimit të projekteve ndryshojnë nga thirrja në thirrje, nga viti në vit, nga programi në program.

Në këtë program Bashkimi European ka bërë një përjashtim, i ka zbutur kushtet që ka vendosur në thirrje.

Nuk është vetëm Shqipëria, por janë një sërë vendesh kryesisht të Ballkanit Perëndimor, por edhe vende të tjera të Europës Juglindore dhe të Europës Lindore, të cilët nuk kanë një performancë të barabartë me Bashkimin European. Këto vende kanë hapur një nënprogram horizontal të programit të madh të Horizont, që quhet *Why Dare*, domethënë një program i zgjerimit të kërkimit shkencor dhe për vende të tjera si Portugalia, si Spanja, si Çekia, si Sllovakia apo si vende të Ballkanit Perëndimor, të cilët nuk janë në të njëjtin start me vendet e tjera dhe për këtë arsye nuk kanë të njëjtën performancë me vendet e tjera.

Lajmi i mirë është që në këtë program, në vitin e parë të këtij programi, Shqipëria ka performuar shumë mirë, do të thosha unë. Janë dy organizata, të cilat kanë aplikuar dhe kanë fituar një vend si koordinatore, për herë të parë, si koordinatore të projekteve të konsorciumit të madh. Ky është një hop cilësor që kanë bërë organizatat shqiptare në performancën e përgjithshme në Horizont. Është një universitet privat dhe bashkia e Tiranës, që kanë aplikuar dhe kanë fituar si koordinatore.

Nga ana tjetër, për t'iu përgjigjur pyetjes, se cilat janë institucionet që kanë përfituar fonde dhe nëse janë publike apo private, institucionet janë të të gjitha llojeve, janë universitete publike, janë universitete private. Në numër projektsh dominojnë universitetet publike. Edhe në fondin e publikuar dominojnë universitetet publike, por ky nuk është një tregues, që na tregon ndonjë gjë të madhe. Për shembull, Universiteti i Mjekësisë i Tiranës që renditet i pari si përfitues i programit Horizont 2020, ka fituar një fond prej 1 milion e 49 mijë euro, ndërkohë kemi, edhe universitete

publike, edhe private që kanë përfituar fonde prej 12 mijë euro ose 13 mijë euro. Pra, e rëndësishme është që universitet tona, qofshin publike, qofshin private, por jo vetëm universitetet, edhe institucionet duhet të aplikojnë për të marrë fonde të Komitetit European. Për shembull, edhe bashkitë kanë aplikuar për fonde. Bashkia e Përmetit është bashkia e dytë në Shqipëri, që ka përfituar fonde të Horizont. Kjo do të thotë që, nuk kemi një ndarje, se për shembull Universiteti i Tiranës, i ka kapacitet më të mëdha, po sa e ka dhe si e ka performancën. Ndonjëherë është aftësia e ekipeve kërkimore për të gjetur konsorciumin e duhur, konsorciumin fitues. Roli i shqiptarëve në këtë konsorcium është modest, është shumë modest. Domethënë, nuk prevalojnë as CV-të e shkencëtarëve shqiptarë, as profilet e organizatave kërkimore shqiptare, kur bëhet fjalë për të vendosur se cili konsorcium do ta marrë këtë apo atë projekt.

Kështu që, duhet të jemi të ndërgjegjshëm, se patjetër që kemi bërë progres, por do të bëjmë progres edhe më tej. Unë jam e bindur se në programin e ardhshëm ne do të arrijmë te 20 milionë euro, pa diskutim, sepse këto janë tendera dhe ky është një parashikim që ne e lidhim me disa indikatorë, sesi zhvillohen disa indikatorë, që ndikojnë në kërkimin shkencor në Shqipëri.

Për sa i përket rolit të Ministrisë së Arsimit, dua të them se ajo ka një rol për të prezantuar mekanizmat e duhur ose për të nxitur mekanizmat e duhur në universitetet shqiptare dhe institucionet kërkimore, që ato të marrin pjesë në kërkim shkencor. Unë do t'ju përmend vetëm një fakt: në vitin 2019 qeveria shqiptare ka iniciuar një program tërësisht të ri për kërkimin shkencor, programin e investimit të infrastrukturës të kërkimit shkencor. Ky program nuk ka qenë më përpara në buxhetin e Ministrisë së Arsimit, por duke filluar nga viti 2019 ne investojmë rreth 15 projekte në vit për kërkimin shkencor, kryesisht në universitet publike, ndonjë gjë të vogël edhe tek universitetet private, por kryesisht në universitet publike. Ky është një element shumë i mirë, sepse tani kemi arritur të kemi disa laboratorë që janë unikë edhe në Ballkan apo që nuk i gjen edhe në Itali. Këta janë laboratorë të investuar shumë mirë, të fjalës së fundit të shkencës, të cilët u japin premisa shkencëtarëve shqiptarë që të bëjnë aty eksperimente, kërkime të denja dhe të krahasueshme me vende të tjera të Europës.

Një mekanizëm tjetër po i Ministrisë së Arsimit është nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshë ndërmjet Agjencisë Kombëtare për Kërkim Shkencor dhe institucioneve homologe të Komunitetit European. Po flas për vitet e fundit, ku kemi nënshkruar marrëveshje me Italinë, me Austrinë, dhe me Kosovën. Gjithashtu, kemi rijetëzuar një marrëveshje që ka qenë dikur, por që u la për një periudhë të gjatë kohe e fjetur, me TUBITAK-un, me Turqinë, që është një nga



institucionet më prestigjioze të kërkimit shkencor në Europë. Pra, le të themi, që iniciativat për të lidhur marrëveshje me universitete dhe agjenci homologe të mbështetjes së kërkimit shkencor, kanë qenë gjithmonë një nga prioritetet e Ministrisë së Arsimit.

Tjetra, nëse do të shikojmë shifrat e financimit të kërkimit shkencor, ato janë rritur në vazhdimësi. Domethënë, kurba për financime në buxhetin e kërkimit shkencor, të paktën 5 vjetët e fundit ka qenë gjithmonë në rritje. Nuk flas për programin e ri që është shtuar, atë që përmenda pak më parë, por edhe për projekte të kërkim – zhvillimit, pra projekte tipikisht kërkimore të studiuesve shqiptarë.

Njëra nga pyetjet ishte se cilët ekspertë do të mbështesë Ministria e Arsimit për të ngritur kapacitetet. Domethënë, grupi i ekspertëve që Ministria e Arsimit ka në dispozicion janë ata që zëvendësministrja i përmendi, pikat e kontaktit për Horizont. Pikat e kontaktit janë një trupë e personave, që janë të lidhur me kërkimin shkencor, pra shkencëtarët sipas fushave të ndryshme që i përcakton vetë Horizonti. Kjo është si të thuash njësi bazë me të cilët ne punojmë çdo ditë, për të dhënë mundësinë e aksesit në të gjitha informacionet që prodhon vetë Horizonti ose vetë Komiteti Europian, që lidhen me kërkimin shkencor. Pra, këta janë njerëzit, që janë vazhdimisht të lidhur me kërkimin shkencor dhe me Horizontin. Sigurisht, këta janë njerëzit që janë më afër Ministrisë së Arsimit dhe më afër Agjencisë Kombëtare për Kërkim Shkencor dhe Inovacion.

**Petro Koçi** - Agjencia është *leads*?

**Mirela Muça** - Ne nuk jemi *leads*, ne jemi mbështetës. Ne jemi institucioni promovues. Ne mbështesim me informacion gjithë këtë trupë, që sapo përmenda, duke u dhënë mundësinë që të marrin pjesë në çdo trajnim, që vetë Komiteti Europian inicion për ngritjen e kapaciteteve të NCP-ve, pasi janë trupa që ekzistojnë në çdo vend të Komitetit Europian apo vend anëtar.

**Ina Zhupa** - I paguani ju?

**Mirela Muça** – I paguajnë vetë universitetet, sepse këta janë përfaqësues të universiteteve. Pra, është *një bottom up approach*. Domethënë, këta individë janë përzgjedhur nga vetë universitetet. Vetë universitetet kanë sjellë kandidaturat e tyre se kush do të jetë NCP në fushën e turizmit, për shembull, ose të bujqësisë. Pra, quhen *National Contact Points, NCP*.

Ndërsa, ajo që tha zëvendësministrja për trajnimet dhe për programet studimore në shkrim projektësh, sigurisht ato janë të hapura për të gjithë. Ekspertët e institucioneve qendrore, ministrive ose bashkive mund të marrin pjesë për të ngritur kapacitetet e veta, për të shkruar projekte. Nuk bëhet fjalë vetëm për shkrim projektësh në kuadrin e Horizontit, por për çdo projekt tjetër.

Mbas anëtarësimit, ne do të përgatitemi për projekte strukturore, që to do të jenë shumë herë më të vështira se projektet IPA, Erasmus, Horizont, që kemi deri tani, kështu që ne duhet të fillojmë të përgatisim njerëzit, të cilët do të dinë të lexojnë dhe të shkruajnë projekte sipas guidave që jep Bashkimi Europian.

**Petro Koçi** - Ishte një pyetje për vendet e punës. Këtu bëhet fjalë për vende të punës që krijon vetë kërkimi, pra ata që angazhohen në kërkim shkencor apo vendet e punës që një kërkim shkencor i aplikuar në praktikë sjell vende pune.

**Mirela Muça** – Për shembull, nga eksperiencat e mëparshme kemi kërkim shkencor, ku organizata kërkimore në bashkëpunim e biznesin kanë aplikuar në projekte për të zgjidhur problematika të biznesit, që biznesi has. Kjo ka sjellë jo vetëm zgjidhjen e problematikave, por edhe hapjen ose transferimin e teknologjive në një biznes, i cili sigurisht hap mundësitë e vendeve të punës, sidomos për të rinjtë, të cilët janë patjetër të mirëshkolluar ose që kanë marrë pjesë në këto projekte.

Veç kësaj, unë do të përmend edhe një mekanizëm tjetër, që është shumë i ri dhe që vlen ta përmend këtu edhe për deputetët. Shqipëria për herë të parë ka marrë pjesë në një konkursium, që është mbareuropian, që është Eureka. Eureka është një konkursium i udhëhequr me rotacion nga vende të ndryshme të Bashkimit Europian, ku Shqipëria mund të përfitojë në fushën e transmetimit të teknologjive dhe ky është një program drejtpërdrejt i lidhur me biznesin, dhe drejtpërdrejt i lidhur me hapjen e vendeve të punës. Ne kemi aderuar për herë të parë në qershor të vitit të kaluar. Jemi duke kaluar fazën e akomodimit të institucioneve shqiptare me këtë program dhe besoj se shumë shpejt do të kemi edhe aplikime në këtë konkursium, që do të jetë me shumë vlerë për biznesin shqiptar dhe sigurisht edhe për tregun e punës.

**Florian Nurçe** - Mund të plotësoj diçka në lidhje me tarifën e paguar nga Shqipëria dhe kontributin e fituar?

**Petro Koçi** – Po, vazhdoni.

**Florian Nurçe** – Unë jam Florian Nurçe nga departamenti i buxhetit dhe menaxhimit financiar në Ministrinë e Arsimit.

Ky është programi i tretë që ju po ratifikoni. Shqipëria ka marrë pjesë në dy programet kuadër 2007 - 2013 dhe 2014-2020. Fondet që ka pasur Komisioni Europian ka qenë të konsiderueshme. Marrëveshjet e ratifikuara me Shqipërinë kanë qenë edhe pozitive, edhe mbështetëse. Në fazën e parë, pavarësisht se shkencëtarët tanë kanë përfituar 2 milionë euro, në

marrëveshje ishte parashkruar që 70% e tarifës së paguar nga Shqipëria do të rimbursohet pas kryerjes së shpenzimeve dhe në për çdo pagesë që kemi kryer, pavarësisht shkallës së suksesit nga shkencëtarët apo institucionet shqiptare, kemi marrë rimbursim, ku shuma e paguar me shumën e përthithur nga institucionet apo kërkuesit shqiptarë me shumën e rimbursuar e tejkalon shumën e paguar.

Njëkohësisht, edhe për programin Horizont 2020, 2014-2020, pavarësisht vitit 2020, kur ndodhi pandemia dhe situatës jo të këndshme për aplikimet apo për fituesit e projekteve, Shqipëria ka paguar 8 milionë dhe bashkë me përfituesit e projekteve që kanë përthithur 5,3 apo 5,5 milionë euro dhe shumën e rimbursuar ka marrë gati 10 milionë euro. Domethënë, në kemi marrë koeficientin maksimal që të lejon programi të fitosh, mbi 8% të shumave të paguara.

Më e rëndësishmja është që, nëse në fazën e parë kanë aplikuar dhe kanë fituar 20 projekte, në fazën e dytë janë 47 projekte. Numri i projekteve, numri i kërkuesve të angazhuar është një shkollë me vete, se punojmë me liderët e projekteve. Për herë të parë, në këtë fazë të tretë, edhe nga shqiptarët kanë dalë dy lider projekti. Uroj që në thirrjen e vitit 2022 apo 2023 të ketë më shumë lider projekti.

Është për t'u theksuar se fondi në dispozicion është i konsiderueshëm, 95 milionë euro. Çdo vit është 13 miliardë euro dhe Shqipëria nëse paguan 1,3 milionë euro në vit dhe mund të fitojë 1,5 apo 1,1, milionë euro, shkalla e suksesit përsëri na lejon që përsëri të fitojmë 8% plus të çdo viti apo në tërësi ndaj pagesave të kryera ndaj Komisioni Europian.

Siç e thanë edhe drejtoresha, edhe zonja zëvendësministre, programi në këtë fazë të tretë është më dashamirës ndaj kërkuesve, ndaj shkruarëve të projekteve dhe ndaj produkteve që priten të realizohen.

Faleminderit!

**Petro Koçi** – Faleminderit!

Dua të them që, praktikisht me *fee*-në që ne paguajmë dhe me përftimin, duke përjashtuar rimbursimin, del që aq sa financohet, praktikisht jemi duke e financuar ne me paratë tona. Pra, ne na duhet që të mos dalim sikur po financojmë kërkimin shkencor të të tjerëve, ne duhet të financojmë kërkimin tonë shkencor. Falë rimbursimit kjo është një situatë e rregulluar, por ju po thoni që përvoja po bën të vetën. Pra, të gjithë njerëzit që angazhohen në kërkimin shkencor, strukturat universitare apo akademikët janë tashmë me një ekspertizë të fituar nga dy projektet e

mëparshme, të cilat e rrisin shansin që ne vërtet të kemi një situatë gjithnjë edhe më të financuar për kërkimin shkencor.

Unë mendoj, gjithashtu, se ministria duhet të bëjë tri gjëra, ose qeveria përfshirë dhe Agjencinë.

E para, informacion, sepse mendoj se ka nevojë që të rrisë informacionin. Pra, të jepet informacion, që mund të përfitohet nga ky program, i cili duhet çuar kudo. Ju më thatë që ka përfituar bashkia e Përmetit, për shembull. A e kanë të gjitha bashkitë këtë lloj informacioni? A tentohet çdo vit t'u çohet informacioni se çfarë kërkon ky program për këtë vit apo për vitin që vjen?

E dyta është organizim, se duhet patjetër organizimi. Pra, duhen takime jo vetëm për informim, por edhe për të krijuar strukturën e nevojshme, që e bën më funksionale përfitimim nga ky projekt.

E treta është ajo që thamë që në fillim, trajnim me ekspertizë, vendase tashmë, sepse është krijuar ekspertiza vendase. Pra, ajo përvojë mund të përhapet edhe tek të tjetër, plus ekspertizë ndërkombëtare. Pra, ne mund të finalizojmë pak për të përfituar edhe ekspertizë kombëtare, për teknologjinë e aplikimit e kam fjalën, sepse kjo ne na ndëshkon edhe në projekte të tjera. Teknologjia jonë e aplikimit është ende në nivele të ulëta.

Vazhdoni, zonja zëvendësministre.

**Albana Tole** – Atëherë, në lidhje me ekspertizën, ne e kemi kërkuar ekspertizën, ashtu sikurse e përmenda pak më parë, nga institucionet partnere dhe ndërkohë jemi duke evidentuar ato figura që kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në shkrimin e projekteve. Pra, ideja është që, do të jetë një bashkëpunim, nuk është se do të jenë vetëm ekspertë të huaj, sepse duhen konsideruar edhe dinamikat që ka vendi, pra dinamikat që ka Shqipëria në rastin konkret.

Në lidhje me organizimet, sigurisht që vlen përvoja në këto 14 vjet dhe ngritja e strukturave që do të merren me trajnimet ose më mirë, organizmi i trajnimeve dhe programeve, që do të formojnë shkrimin e projekteve, do të rrisin kapacitetet. Në të njëjtën kohë, informacioni është dhënë dhe jepet nga ministria dhe njëkohësisht nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.

Gjithashtu, të gjithë pedagogët e rinj, të gjithë kërkuesit shkencorë të rinj, janë të mirinformuar tanimë, sepse vijnë nëpërmjet një përvoje 14-vjeçare, ku është thënë, rithënë dhe stërthënë hapja e programit në fjalë, për mendimin tim, ajo mbi të cilën duhet insistuar më shumë

është që institucionet e arsimit, ashtu sikurse bëjnë me pjesën e didaktikës frontale, pra, me leksionet e hapura në auditor, të kenë një kohë të përcaktuar që t'ia dedikojnë pjesës së kërkimit shkencor dhe të shkrimit të projekteve, duke pasur një impakt më të drejtpërdrejtë.

Për sa i përket pyetjes për “*Albanian Excellence*”, nga ana e Ministrisë së Arsimit janë kontaktuar rreth 120 ekspertë shqiptarë. Pra, nëpërmjet Ministrisë së Arsimit kemi lidhur një komunikim me ta. Ndërkohë, këta ekspertë janë duke u angazhuar për të dhënë një kontribut të drejtpërdrejtë në institucionet e arsimit të lartë, por në të njëjtën kohë shërbejnë edhe si kontakte për të lidhur marrëveshje ndërmjet institucione të arsimit vendase dhe atyre të huaja. Pra, është duke u punuar me këta ekspertë, të cilët janë kontaktuar në vende të ndryshme të Bashkimit European.

**Petro Koçi** - Faleminderit!

Ka ndonjë gjë tjetër?

Në fillim e ka fjalën kolegia dhe më pas zonja Zhupa.

**Andia Ulliri** – Ky projekt ka nisur në vitin 2007, siç e thatë edhe ju, dhe të gjithë ne e kuptojmë se është kusht që Shqipëria të anëtarësohet në Bashkimin European, duke na dhënë ne njëfarë mundësie për të pasur prioritet kërkimin shkencor.

Në fakt, në dëgjesat që kemi pasur me universitetet, kërkimi shkencor ka qenë një nga kërkesat e tyre primare, duke treguar se ka një lloj boshllëku në këtë aspekt. Për sa u përket problematikave që ne hasim në arsim, nisur edhe nga eksperiencia me Covid-19 në vitet 2019-2020, ato kanë të bëjnë me mungesën e financimeve dhe mungesën e projekteve për të pasur një lloj stimulimi të universiteteve dhe po ashtu të bashkive. Këtë gjë e tregojnë edhe rankimet e universiteteve tona në rajon, të cilat kanë qenë relativisht të ulëta. Kjo lloj performance tregon se ne kemi vërtet disa problematika që duhen adresuar.

Pavarësisht këtyre fakteve, Maqedonia e Veriut ka deklaruar se ka organizuar dhjetë ditë trajnime për aplikimet mbi këtë projekt, me qëllim aprovimin e sa më shumë projekteve, trajnimeve, siç është edhe “Horizont 2020”, si edhe projekti që do të jetë në vazhdim për vitet 2021-2027.

Pra, cilat janë problematikat që ne kemi hasur në aplikime? A vijnë këto problematika në infrastrukturë vetëm nga mungesa e trajnimeve apo vijnë edhe nga moskontakti që ata kanë me grupet *contact points* ose problematika që ju i keni evidentuar? A ka pasur një analizë nga Ministria

e Arsimit për këto problematika, duke na dhënë ne një avantazh që të kemi mundësi për të thithur më shumë fonde me aplikimet e reja që do të kemi në vijim?

Për sa i përket përqindjes së këtij programi që është orientuar drejt studentëve, sa prioritarë janë ata dhe çfarë performance keni pasur ju në reklamimin e këtyre programeve në bashki dhe universitete? Këto ishin disa nga pyetjet, duke qenë se shumica e pyetjeve të tjera që kisha u ezauruan.

Faleminderit!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, problematikat që ju keni evidentuar.

Pra, duke parë se keni pasur probleme në aplikime ose në infrastrukturën tuaj, cilat kanë qenë problematikat më të mëdha që kanë lënë këtë lloj boshllëku, që nuk na mundëson neve të kemi më shumë programe fituese?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, përqindja e këtij programi që orientohet drejt studentëve.

**Petro Koçi** - Faleminderit!

Përpara se t'ia jap fjalën e fundit zonjës Zhupa, u jepni përgjigje pyetjeve të zonjës Ulliri.

**Albana Tole** – Në lidhje me problematikat e evidentuara, ashtu sikurse u përmend edhe më parë, programet “Horizont Europe” apo Horizont 2020” e të tjera me radhë, ekzistojnë prej shumë vitesh, por ky është një proces relativisht i ri për Shqipërinë. Pra, është një proces që i përket 15 vjetëve të fundit. Detyrimisht, problematika e evidentuar është mungesa e përvojës dhe eksperiencës, pasi ne kaq kohë kemi që jemi hapur kundrejt pjesëmarrjes në këto lloj programesh. Pra, edhe vendet e tjera të Bashkimit European, në momentin që janë angazhuar për të marrë pjesë në programe të këtij lloji tipi, u është dashur të punojnë dhe të kenë kohën në dispozicion që të mund t'i përshtaten kërkesave që kanë këto lloj programesh, pa llogaritur faktin që secili program ka disa specifika dhe disa dinamika që ndryshojnë. Pra, edhe modalitetet se si merret pjesë nëpër projekte të ndryshme vijnë duke u përmirësuar apo duke u ndryshuar.

Kjo në vetvete nënkupton edhe një angazhim, i cili duhet të jetë i dedikuar nga ana e stafeve por, në të njëjtën kohë, edhe një nevojë, ashtu sikurse u tha edhe pak më parë, për të ngritur kapacitete, për të formuar stafet që të jenë të dedikuara. Këto stafe, sa më gjatë të punojnë brenda institucioneve, pra, të konsiderohen si stafe stabël, të cilat merren me kërkimin shkencor dhe me

marrjen pjesë nëpër projekte, aq më shumë do të mund të japin një kontribut të vyer për pjesën e pjesëmarrjes nëpër programe të këtij lloj tipi.

Problematika të tjera të evidentuara, përveç mungesës së përvojës, kanë të bëjnë edhe me faktin që pedagogët dhe stafi akademik, që është pjesë e institucioneve, do të duhet të kishin një kontribut më të drejtpërdrejtë në marrjen pjesë nëpër projekte kërkimore. Pra, nuk duhet të fokusohen vetëm te zhvillimi i didaktikës frontale, por duhet të jenë më të hapur ndaj kërkimit shkencor dhe ndaj pjesëmarrjes nëpër programe kuadër të këtij lloj tipi, të cilët do të kthehen në benefite në një moment të dytë për vet kërkimin shkencor, por edhe për zhvillimin e vendit.

**Mirela Muça** – Ju thatë që Maqedonia ka bërë 10 ditë trajnim, kurse ne kemi bërë 24 ditë trajnim për programin “Horizont” gjatë vitit 2021.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Për këtë projekt, sepse ky program ka filluar në vitin 2021. Ne kemi pasur një vit kohë. Pavarësisht se nuk e kemi nënshkruar marrëveshjen, Komisioni European u ka lënë vendeve të Ballkanit Perëndimor 1 vit kohë të drejtën për të aplikuar nëpër projekte për të kryer të gjithë procedurën e vlerësimit të projekteve.

**Petro Koçi** - Edhe përpara ratifikimit?

**Mirela Muça** - Po, edhe përpara ratifikimit. Tani kemi disa projekte fituese, por po presim ratifikimin e kësaj marrëveshjeje në mënyrë që të rimbursohen. Domethënë, na presin ne që ato të rimbursohen për aktivitete të kërkimit shkencor.

Lidhur me disiminimin e informacionin, ne e kemi tejkalluar këtë gjë. Programi është shumë familjar në kuptimin e shpërndarjes së informacionit. Është një faqe shumë e thjeshtë për t'u aksesuar dhe shumë mirë e lexueshme. Universitetet janë të njohura shumë mirë me të gjithë programin. Ajo që na mbetet ne për të bërë është mbështetja konkrete për shkrimin e projekteve, se, në fund të fundit, në universitete ne kemi shkencëtarë, nuk kemi shkruer projektet. Kështu që, na duhet t'i bashkojmë këto dy aftësi dhe ne po përpiqemi të bëjmë pikërisht këtë gjë. Nuk është një model që po e shpikim vetë, sepse e kanë bërë edhe vende të tjera të dyta të komunitetit european, ai Spanja, Greqia e të tjera.

**Petro Koçi** - Pa dashur t'ju ndërpres, shpërndarja e informacionit bëhet rastësore apo e organizuar?

**Mirela Muça** – Ne kemi një databazë.

**Petro Koçi** - Ju u dërgoni të gjitha universiteteve ...

**Mirela Muça** - Jo të gjitha universiteteve, por të gjithë atyre që janë kërkues shkencor në Shqipëri. Ne kemi një databazë ...

**Petro Koçi** - Si individë?

**Mirela Muça** – Si individë. Sigurisht, edhe universiteteve, edhe zëvendësrektorëve, që merren me kërkimin shkencor, që mbulojnë kërkimin shkencor, por edhe individëve. Ne kemi një databazë me 3900 ...

**Petro Koçi** - Edhe institucioneve, bashkive ...

**Mirela Muça** – Pa diskutim edhe institucioneve. Të gjithë atyre që janë aplikantë potencial për këtë program.

**Petro Koçi** - Bizneseve private, sidomos këtyre që kanë ...

**Mirela Muça** – Ne kemi një faqe interneti të hapur dhe te zyra jonë trokasin ...

Domethënë, çdo njeri që mendon se mund të aplikojë në këtë program.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Për sa u përket studentëve, ky është një grant konkurrues. Kur shkon të aplikosh në “Horizont”, ai është një grant konkurrues ku konkurrohet me CV. Domethënë, CV-ja e profesorit që duhet të marrë pjesë si koordinator duhet të jetë shumë mirë.

**Petro Koçi** - Për shembull, kur aplikojnë pedagogët ose kërkuesit shkencorë, a ndodh shpesh që janë bashkë me grup studentësh apo jo? Kjo është ideja.

**Mirela Muça** – Patjetër që studentët marrin pjesë.

**Petro Koçi** - Duhet të jetë ndonjë talent i rrallë që të marrë pjesë vetë studenti. Ishalla paçim sa më shumë!

**Mirela Muça** – Patjetër që marrin pjesë, sepse i gjithë kërkimi dhe i gjithë aktiviteti zhvillohet në laboratorët e universitetit, por jo vetëm, zhvillohet edhe në industri, në biznes, në OJQ, në bashki, në institucione. Pra, jo vetëm studentët, por i gjithë stafi i institucioneve, stafi i bashkisë, i OJQ-ve, marrin pjesë në projekte kërkimore atëherë kur ato kanë mundësi të fitojnë.

**Petro Koçi** - Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Zhupa.

**Ina Zhupa** – Faleminderit!

Ka qenë përgjigjja më mikse që kam marrë ndonjëherë, edhe për shkak se gjatë kohës që dëgjonim përgjigjet e pyetjeve, drejtuesi i seancës na ndihmonte me komente mbi pyetjet. Po ashtu,



pata fatin të merrja edhe përgjigjen për pyetjen e studentëve, sepse e risolli në vëmendje kolegja Ulliri.

Megjithatë, kam diçka tjetër për t'u qartësuar.

Ju thatë se në “*Albanian Excellence*” keni evidentuar apo keni renditur rreth 120 ekspertë shqiptarë. E para, si ta kuptoj këtë, sepse renditje të thjeshtë të ekspertëve që jetojnë jashtë ka bërë edhe Fevziu gjatë pandemisë. Gjente 30 ekspertë që jetonin jashtë dhe i merrte në pyetje.

Unë u lumturova që kishte kaq shumë njerëz me kapacitete të larta, por nuk ju pyeta thelbësisht për këtë. Pra, këta 120 ekspertë, që ju keni evidentuar, thjesht e dini që jetojnë jashtë dhe u keni një CV apo janë përfshirë në projekte, keni një mekanizëm për t'i përfshirë në projekte apo i paguani për ekspertizë pranë agjencisë? Pra, cila është mënyra që ju i përfshini ata, qoftë në këtë projekt, qoftë edhe në kuadër të agjencisë? Pra, nuk duhet thjesht evidentimi i tyre apo të thuhet që këto janë CV-të dhe pastaj të mund t'i përdorim për të thënë ...

E dyta, në referencë të përgjigjeve që kam marrë nga ju, sa herë ka shkuar agjencia juaj, ekspertët e ministrisë, apo së bashku, në universitete për trajnime qoftë me këtë, qoftë me të tjera dhe a keni një kalendar që ju shkoni, për shembull, dy herë në tre muaj në këto universitete dhe i njoftoni për thirrjet, shikoni nevojat që ata kanë për trajnime, i evidentoni si agjenci, për të qenë edhe më afër universiteteve, por edhe juve ju ndihmon, sepse kryeni më mirë funksionin tuaj?

Për sa i përket pjesës që jemi vend i vogël dhe me kapacitete të vogla, është thjesht mungesa e vizionit dhe e dëshirës së politikës, në këtë rast të qeverisë, për të bërë më shumë për arsimin. Në këtë rast nuk është faji juaj, se nuk e miratoni ju buxhetin që ju jep kryeministri Rama, por mjafton t'ju them një fakt të thjeshtë.

Që nga viti 2013, në premtimet e Aleancës për Shqipërinë Europiane, më pas me manifestin e vitit 2017, e me “Tepsinë 3” tani, thuhet premtimi për 5% të GDP-së buxhet për arsimin. Ndërkohë, jo vetëm që nuk e keni arritur, por nuk krahasoni as me vende si Kosova apo Mali i Zi. Kjo jo për fajin tuaj si drejtor apo fajin tuaj si zëvendësministre, por janë politikat e qeverisë, që ju përfaqësoni, që na shtojnë të jemi gjithmonë të fundit në rajon për arsimin në të gjitha drejtimet. Rankimi i fundit që u bë publik, që kishte të bënte me *web*-et, dhe me cilësinë e *web*-eve, tregonte që Shqipëria ishte në vend të fundit, kurse ministrja u shfajësua në parlament, duke thënë se është thjesht për *web*-et.

Në epokën që ne jemi, në epokën e digjitalizimit dhe atë që ju pretendoni se do të bëni rezolucionin e digjitalizimit të universiteteve, të kërkimit shkencor, kjo duhet të kishte marrë një

pjesë të rëndësishme edhe të vëmendjes suaj, sepse, siç e thatë ju me të drejtë, të dhënat për këtë projekt aksesohen në *web*, ndërkohë që vetë universitetet tona vuajnë për të pasur një prezantim sa më të mirë në anën e *web*-eve të digjitalizimit. Ky mund të jetë një nga projektet që ju mund të bëni dhe mund të fitoni, që të digjitalizonit dhe të krijoni pasqyrën digjitale të universiteteve shqiptare, edhe me ndihmën e agjencisë suaj, edhe me ndihmën e ministrisë.

Faleminderit!

**Petro Koçi** - Faleminderit, zonja Zhupa!

Nëse është e nevojshme, përgjigjuni pyetjeve që janë brenda rendit të ditës.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Albana Tole** – Në lidhje me ekspertët, ashtu sikurse e përmenda më parë, nga ana e ministrisë janë kontaktuar, jo janë renditur, 120 ekspertë në vende të ndryshme të Bashkimit Europian dhe është kërkuar bashkëpunim me ta për aspekte të ndryshme, duke konsideruar nevojën që kanë institucionet tona të arsimit të lartë dhe duke konsideruar nevojat që ka arsimi. Ky është një proces që po vazhdon të ndiqet. Ajo që ne kemi bërë deri tani është që kemi kontaktuar me ta, nuk kanë dërguar thjesht një CV, dhe jemi duke diskutuar nevoja të ndryshme që evidentohen dhe ku mund të adresohet ekspertiza e tyre.

**Mirela Muça** – Në lidhje me planifikimin, ne kemi një kalendar formal, të cilin e ndjekim. Vitin e kaluar ne kemi bërë 24 ditë trajnim për universitetet lidhur me thirrjet e dala vitin e kaluar.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Shkojmë ne tek universitetet.

Viti 2020 ka qenë pak më i vështirë sepse i kemi bërë *online*. Sigurisht, ka pasur pjesëmarrje pak më të madhe, por edhe vështirësi të mëdha për ta disiminuar të gjithë informacionin që ne kemi. Ne nuk shkojmë vetëm në universitete, por në çdo thirrje që na bëjnë universitete, fakultete, departamente të ndryshme, të cilat duan asistencën tonë që lidhet me programin, me thirrjen konkrete. Për shembull, kur ka një thirrje të veçantë për ushqimin, ne shkojmë në Universitetin Bujqësor dhe mbledhim të gjithë ata që janë aplikantë potencial për këtë thirrje.

Lidhur me renditjen e universiteteve në *web*, unë nuk dua të them asnjë fjalë më shumë nga sa ju ka thënë ministrja, por agjencia është një nga përfitueset në programin “Horizont”. Pra, ne kemi aplikuar me një program që ka të bëjë me ACRIS (*Albanian Research Information System*). Domethënë, ne duam të ngremë një bazë informacioni, ku universitetet të hedhin të dhënat që kanë

vetëm për kërkimin shkencor dhe për trupën e kërkuesve shkencorë. Kjo do të thotë se ne jemi në një korsorcium me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe duam të ngremë këtë platformë për universitetet shqiptare. Në fakt, nuk duhet vetëm vullneti i njëanshëm i ministrisë, por duhet edhe vullneti i universiteteve për ta bërë këtë.

**Petro Koçi - Faleminderit!**

Unë besoj se erdhëm në fund të mbledhjes. Do të bëjmë procesin e votimit dhe pastaj do t'ju jap një informacion.

Besoj se ishte një seancë me shumë vlerë, me pyetje-përgjigje, me sqarime, me nxitje të qeverisë, që të shfrytëzojmë të gjitha kapacitetet e mundshme për të marrë maksimalen nga ky projekt i Bashkimit Europian për financimin e kërkimit shkencor dhe inovacionin. Besoj se, nga të gjitha komentet paraprahe, kemi një mbështetje për ta ratifikuar këtë projekt-marrëveshje, kështu që do t'ju ftoja ta votojmë në parim.

Kush është dakord? 10 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Neni 1.

Kush është dakord? 10 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2.

Kush është dakord? 10 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

E hedhim projektligjin në votim në tërësi.

Kush është dakord? 10 vota pro. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Përpara se ta mbyll mbledhjen, dua t'ju njoftoj se Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar u ka dërguar disa institucioneve parlamentare dhe qeveritare një peticion të firmosur nga 59 anëtarë të tij, ku kërkon të rihapen sërish dhe të rregullohen me ligj bastet sportive. Ne si komision nuk e kemi drejtpërdrejtë përgjegjësi, por nga pikëpamja e edukimit nuk është se e nxisim shumë shpirtin e lotarisë.

Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Faleminderit, të ftuar!

Faleminderit, kolegë!

